

Plehrimi

Plehrimi duhet të paraprihet nga testet laboratorike të tokës. Një shenjë e mirë e sasive të mjaftueshme të lëndëve ushqyese është ngjyra e errët e gjetheve të mëdha, dendësia e tyre në fidanë dhe



një rritje e ndjeshme e masës vegetative.

Gjethet e vogla dhe të zbehta tregojnë mungesë të lëndëve

ushqyese në tokë të papërshtatshme për një zhvillim normal të bimëve. Aronia mund të plehrohet me plehra natyrale (organikë) ose mineralë. Plehrat e lëngshëm, si fosfori dhe kaliumi, nuk duhet të përdoren në vjeshtë ose në pranverë shumë të hershme, ndërsa plehrat e azotit rekomandohen dy herë ose tri herë gjatë sezonit të vegetacionit, duke filluar nga muaji prill dhe plehrimi i fundit bëhet në muajin qershor. Sasia që mund të përdoret: P (fosfori), 80-100 kg/ha, K (potasi), 100-150 kg/ha, N (azoti), 100 -150 kg/ ha.

Krasitja

Është një nga procedurat më të rëndësishme, qëllimi i së cilës është heqja e degëve të dobëta ose të dëmtuara. Krasitja rekomandohet në dimër në muajt (shkurt; mars). Krasiten ato degë të cilat vështirësojnë vjeljen ose (sjellin bllokimin e rreshtave), pjesët e vjetra në bimë dhe bëhet largimi i numrit të tepërt të lastarëve të rinj, duke lënë vetëm ato më të shëndetëshme, të cilat do të zëvendësojnë fidanët e vjetër në të ardhmen.



Mbrojtja kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve

Aronia nuk shkakton probleme, pasi nuk preket shumë nga sëmundjet dhe dëmtuesit. Herë pas here, aronia, sidomos fidanët e saj të rinj, sulmohen nga *aphids* ose *caterpillars* të cilët hanë gjethet duke dëmtuar bimën. Në raste të tilla, duhet aplikuar spërkatja me insekticid.

Vjelja e Aronias

Frutat e aronias kanë nevojë afërsisht tre muaj për të arritur pjekurinë. Vjelja mund të fillojë në muajin Gusht, por në varësi të vendit ku kultivohet, vazhdon deri në muajin tetor. Frutat vilen kur kanë marrë ngjyrën karakteristike, janë shumë të zeza ose të kuqe (në varësi të specieve). Vjelja bëhet me kujdes që frutat të mos plasariten. Frutat e vjelë vendosen në forma plastike (arka ose kosha). Gjatë vjeljes së frutave të aronias përdoren doreza për arsye se ngjyra e nxjerrë nga fruti është e vështirë për t'u pastruar nga duart.



Aronia e zezë



Aronia e kuqe

QENDRA E TRANSFERIMIT TË
TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE
VLORË

KULTIVIMI I ARONIAS



ADRESA: SHAMOGJIN
NOVOSELË - BASHKIA VLORË

Vitet e fundit në vendin tonë është rritur interesi për Aronian, arsyeja janë vetitë unike të frutave të saj, të cilat janë lëndë e parë e shkëlqyeshme për përpunim dhe klasifikohen si bimë medicinale për përbërjen e tyre kimike .

Frutat e freskëta të aronias së pjekur përmbajnë 74-83% të ujit dhe 26-17% të masës së thatë respektivisht. Fruta e aronias përmbajnë 18% substanca të tretshme, si sheqernat, acidet, taninet, pektinat, pigmentet dhe kripërat minerale. Pjesa më e madhe në mesin e substancave të tretshme janë sheqerna, përmbajtja totale e të cilave në masë fruta të freskëta është 6,2-10,8%, ku 4,3-5,9% janë monosakaride, fruktozë dhe glukozë, ndërsa pjesa tjetër është sakarozë.

Zgjedhja e vendit për kultivimin e Aronias

Aronia përshtatet lehtësisht në kushte të ndryshme mjedisore. Ajo mund të rritet në të gjithë vendin, Kur zgjidhni vendin për kultivimin e aronias, duhet të mbani mend se aronia është bimë e cila ka nevojë për ndriçim të mirë për të prodhuar rregullisht.

Kërkesa vjetore për ujë për kultivimin e aronias janë 500-600 mm shi, por aronia është mjaft tolerante ndaj mungesës së lagështisë dhe lagështisë së tepruar. Për arsye të strukturës së rrënjëve të saj, aronia rritet mirë në toka me ujra nëntokësore të nivelit ulët dhe të nivelit të lartë. Aronia në përgjithësi, nuk rekomandohet të rritet së bashku me pemë apo shkurre të tjera frutore.



Aronia prodhon në toka të pasura, të ajrosura dhe kapacitet të lartë uji. Tokat gurishtore, me përmbajtje të lartë zhavorri dhe tokat kënetore ose të kripura, janë pak të përdorshme. Aronia rritet mirë nëse toka është e përbërë nga argjila ranore me ajrim të mirë dhe kapacitet të mjaftue-



shëm ujit.

KULTIVIMI I ARONIAS Përgatitja e tokës

Një tokë e përgatitur mirë para fillimit të kultivimit është thelbësore dhe do të ketë një ndikim në prodhimin e bimës.

Në radhë të parë, zona duhet të pastrohet nga barërat konkurrues, gjë që do të lehtësojë kultivimin e fidanëve në vitet e para, sepse aronia është e ndjeshme ndaj barërave konkurrues. Në moshën 4-5 vjeçare, aronia është mjaft rezistente ndaj barërave konkurrues.

Një vit para mbjelljes së fidanëve, duhet të kontrolloni aciditetin e tokës, nëse është e nevojshme, nëpërmjet trajtimit me gëlqere pH duhet të jetë 6-7. Një plugim i thellë duhet të paraprihet nga plehrimi fosforik, për tu plotësuar me fosforin lehtësisht të kthyeshëm në shtresat më të thella të tokës. Për toka të varfra plehu organik rekomandohet para mbjelljes së aronias.

Zgjedhja e materialit të fidanëve

Fidanët e aronisë për mbjelljen e përhershme duhet të jenë homogjenë, mundësisht dyvjeçare të zhvilluara mirë. Fidanët shkulen (zakonisht në tetor), materiali duhet të jetë i mbuluar, mundësisht pranë zonës së mbjelljes. Fidanët për mbjellje duhet të jenë të shëndetshëm, të fortë për të siguruar një



zënie të mirë.

Teknika e mbjelljes

Është analoge me atë që përdoret në shumicën e shkurreve dhe pemëve frutore. Pasi të jenë piketuar rreshtat dhe të jenë vendosur piketat hapen, gropat. Në toka më të varfëra gropa hapet me e thellë. Në tokë të dobët rekomandohet hedhja e plehut organik në gropë. Duhet të siguroheni se rrënjët të jenë të përhapura mire në gropë dhe nuk kanë kontakt të menjëhershëm me plehun. Fidanët duhet të mbillen 3-5 cm më thellë se në vendin e rritjes së tyre, pasi do të përmirësojë përhapjen uniforme të kaçubeve. Pas mbjelljes së fidanëve, duhet të kryhet ujitja .

Shërbimet pas mbjelljes

Metoda kryesore e mirëmbajtjes së tokës pas mbjelljes për dy vitet e para është e rëndësishme mbajtja pastër e tokës nga prania e barërave të këqija pasi shpesh ato bëhen konkurrese duke frenuar zhvillimin e bimës. Dy vitet e para toka ndërmjet rreshtave mund të përdoret për të kultivuar perimet dhe bimët papilionaceous (jo drithërat). Duke filluar nga viti i tretë rekomandohet spërkatja në mes të rreshtave me herbicide.